

# AGENTSCHAP INTEGRATIE & INBURGERING

## MANUAL I PËRKTHIMIT ME VIDEO

### ALBANEES | VERTAALD UIT HET NEDERLANDS


Ti merr pjesë në një bisedë online me anë të Google Meet. Një përkthyes me video do të përkthejë.

Kujdesu për / siguro:


- një kompjuter me kamera dhe mikrofoni. Ti mund të marrësh pjesë gjithashtu me një telefon smart aoo me tablet,
- një lidhje interneti të qëndrueshme,
- një ambient të qetë pa zhurmë në sfond!

### 1 Assistenti të fton me anë të e-mail-it.


- 1 Ti merr një e-mail nga asistenti. Me anë të kësaj ftese ti mund të marrësh pjesë në bisedë. Nëse ti merr një ftesë me anë të whatsapp-it, atëherë lexo poshtë më tej se si ti merr pjesë!
  - ▶ Nëse nuk e gjen e-mail-in atëherë shiko në 'ongewenste e-mails' (e-mail-et e padëshirueshëm / spam)!
- 2 Hape e-mail-in! Kliko në 'deelnemen aan vergadering' (merr pjesë në mbledhje)! Është mira të përdorësh webbrowser-in Google Chrome.




### 3 Plotëso emrin tënd!




- 4 Kliko në 'deelnameverzoek' (kërkesë për pjesëmarrje)!



- 5 Prit deri sa asistenti të lejojë të futesh në bisedë! Ti shikon tani këtë pamje:




- 6 Asistenti të jep lejen për t'u futur në bisedë. Aktivizoji/Hapi kamerën dhe mikrofonin tënd me anë të butonave të kuq në pjesën e poshtme të ekranit!




7 Nëse nuk ke video apo zë, atëherë kliko në tri pikat djathtas poshtë! Zgjedh 'instellingen'.

- ▶ Përcaktoji këtu cilësimet e zërit dhe të videos! Nëse as me këtë nuk ia arrin, atëherë kontrollo cilësimet (instellingen) e kompjuterit tënd! Kujdesu që t'i japësh Google Meet lejen për të përdorur kamerën dhe mikrofonin tënd.



8 Për të mbaruar bisedën, kliko në telefonin e kuq në pjesën e poshtme!




## 2 Asistenti të fton me anë të whatsapp-it. Ti merr pjesë me anë të telefonit tënd smart apo tablet-it tënd.


- 1 Instalo aplikacionin Google Meet në telefonin tënd smart apo në tablet-in tënd!
- 2 Ti merr një link (lidhje tranferuese) me anë të whatsapp-it.




- 3 Kliko në link-un! Hape link-un me anë të Google Meet!



- 4 Kliko në 'deelnameverzoek'!



- 5 Asistenti të jep lejen për t'u futur në bisedë. Aktivizoji/Hapi kamerën dhe mikrofonin tënd me anë të butonave të kuq në pjesën e poshtme të ekranit!



#### COLOFON

**Dienst Sociaal Tolken en Vertalen**  
*Agentschap Integratie en Inburgering*  
Tel **02 701 79 20**  
[stv@integratie-inburgering.be](mailto:stv@integratie-inburgering.be)